



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 404 Prot.

Tiranë, më dt. 23.10.2017

VENDIM

Nr.298, dt. 23.10.2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 23.10.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit Ndërtim i HEC “Guri i Zi” në lumin e Kurvajt, Bashkia Mat”, nga shoqëria ARIS ALBANIA sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Banesa e Rustem Dyl Kryekurtit, në fshatin Macukull, Bashkia Mat”
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumbaro Furxhi



SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

Arta Dollani